REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 302, Datë 20.10.2026

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 181, DATË 12.09.2024 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "MAGNA SOLAR POWER" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026, "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s,* miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3091 prot., datë 15.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 12.09.2024"Mbi licencimin e shoqërisë "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

1. **Të dhëna mbi shoqërinë "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 12.09.2024 vendosi të licencojë shoqërinë "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se "*Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n*".

2. **Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Në kuadër të rakordimit të plotësimit të kushtit të sipërcituar, rezulton se shoqëria "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k. ka depozituar në ERE Certifikatën vjetore të monitorimit për vitin 2025, me nr. 3651 prot., datë 03.07.2026, të lëshuar nga AKBN, në të cilën konfirmohet se centrali fotovoltaik është në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara në kontratën nr. 10939 Rep., nr. 4910 Kol., datë 01.08.2022 "*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovotlaik, me kapacitet prodhues 2 MW dhe vprave ndihmëse, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier".*
- Nga të dhënat që ERE disponon në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin shtator 2026, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratën me MIE-n.
- Për gjithë sa më sipër dhe duke qenë se dokumentacioni i depozituar nga shoqëria provon përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e saj dhe, në këtë kuadër, përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 181, datë 12.09.2024

vlerësohet se nuk ekzistojnë më rrethanat që kanë kushtëzuar vendosjen e këtij detyrimi, ndaj propozohet shfuqizimi i pikës 2 të vendimit të sipërcituar.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 12.09.2024, si vijon:

   a) Pika 2 e vendimi, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI